



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULËS CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Nr. 951 prot.

Durrës, më 21/03 /2025

Lënda : Relacion mbi zhvillimin e pyetsorëve të studentëve Master Shkencor dhe Master Profesional përvlerësimin e lektorëve të ftuar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

PROF. DR. SHKËLQIM FORTUZI
REKTOR

I nderuar Z. Rektor,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në funksion të detyrave të Drejtorisë së Kurrikulës Cilësisë dhe Statistikave dhe procesit të Akreditimit Insitucional,

Ju informojmë se me datën 15 dhe 16 Shkurt 2025 ditën e Shtunë dhe Dielë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në ambjentet e Kampusit në Spitallë, Godina Nr 1 dhe Nr 2 u realizua pyetësor i studentëve Master Shkencor dhe Master Profesional për vlerësimin e lektorëve të ftuar.

- Në Fakultetin e Biznesit u realizua pyetësori për 8 lektorë ku morën pjesë 66 studentë.
- Në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike u realizuar pyetësori për 3 lektorë ku morën pjesë 16 studentë.
- Në Fakultetin e Edukimit u realizuar pyetësori për 3 lektorë ku morën pjesë 26 studentë.

Një pjesë e lektorëve të ftuar nuk po zhvillonin mësim në orarin dhe auditorin e përcaktuar në orarin mësimor të miratuar dhe në mbi 40% të klasave ku janë të angazhuar lektorë të ftuar numri i studentëve është nën pesë.

Bashkëlidhur do të gjeni modelin e paplotësuar të pyetësorit dhe analizën e detajuar individuale për çdo lektorë të kryer nga Drejtoria e Kurrikulës Cilësisë dhe Statistikave.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORIA E KURRIKULAVE, CILËSISË
DHE STATISTIKAVE**
Dr. Spiro PAÇO

Programi i studimit : _____

Lënda: _____

Dita / Orari / Auditori: _____



PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E LEKTORËVE

(Të gjitha përgjigjet janë anonime dhe do të përdoren vetëm për qëllime përmirësimi të procesit mësimor.)

1. A ka qenë lektori/ja juaj i/e pranishëm/e rregullisht gjatë të gjithë orëve mësimore?
 - ☐ Po, gjithmonë
 - ☐ Pothuajse gjithmonë
 - ☐ Disa herë ka munguar
 - ☐ Shpesh ka munguar
2. Në rastet kur ka munguar, a janë zëvendësuar orët e humbura?
 - ☐ Po, gjithmonë
 - ☐ Po, por jo të gjitha
 - ☐ Jo, asnjëherë
3. A ka ndodhur që dikush tjetër, përveç lektorit/es, t'ju japë mësim si zëvendësues/e?
 - ☐ Po
 - ☐ Jo
4. Nëse po, a ishit të njoftuar paraprakisht për këtë ndryshim?
 - ☐ Po
 - ☐ Jo
5. Si e vlerësoni zhvillimin e orës mësimore?
 - ☐ Shumë e mirë
 - ☐ E mirë
 - ☐ E kënaqshme
 - ☐ E pakënaqshme
6. A është respektuar përdorimi i literaturës parashikuar për çdo lëndë?
 - ☐ Po
 - ☐ Jo, ka pasur më pak orë se parashikuar
 - ☐ Jo, ka pasur më shumë orë se parashikuar
7. Si do ta vlerësonit përgjithësisht korrektësinë e lektorëve në mësim?
 - ☐ Shumë e mirë
 - ☐ E mirë
 - ☐ E kënaqshme
 - ☐ E pakënaqshme
8. A keni sugjerime për përmirësimin e organizimit të orëve të mësimi?
 - ☐ Po, gjithmonë
 - ☐ Pothuajse gjithmonë
 - ☐ Rrallëherë
 - ☐ Jo, aspak
9. Si do ta vlerësonit mënyrën e mësimdhënies së lektorit/es?
 - ☐ Shumë e qartë dhe e kuptueshme
 - ☐ E qartë, por me vend për përmirësim
 - ☐ Mesatare, disa koncepte nuk u shpjeguan qartë
 - ☐ Jo e qartë dhe e vështirë për t'u ndjekur
10. A mendoni se lektori/ja ka përdorur metoda të përshtatshme për përfshirjen e studentëve gjatë mësimi?
 - ☐ Po, gjithmonë
 - ☐ Pothuajse gjithmonë
 - ☐ Rrallëherë
 - ☐ Jo, aspak